



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE**



RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN

**“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË BRENDSHME TË
ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT KONSULTATIV TË
QEVERISJES QENDRORE ME VETËQEVERISJEN VENDORE”**

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Objekt i këtij projektvendimi është përcaktimi në mënyrë të detajuar i rregullave të brendshme për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore (në vijim referuar “Këshill Konsultativ”) dhe veçanërisht:

- Ndërveprimin midis organeve të strukturës organizative e Këshillit Konsultativ;
- Krijimin, organizimin dhe funksionimin e komisioneve të këshillimit Ad Hoc;
- Organizimin e punimeve të Këshillit Konsultativ dhe komisioneve të tij;
- Procedura për paraqitjen dhe vlerësimin e nismave nga përfaqësuesit e vetëqeverisjes vendore; si dhe
- Detajimin e standarteve të transparencës në Këshillit.

Qëllimet dhe objektivat e këtij projektvendimi janë në përputhje me parashikimet e VKM-së nr.244, datë 17.4.2024 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore”.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim është në përputhje me “Programin e Qeverisë 2021-2025”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” përcakton që marrëdhënia midis pushtetit qendror dhe vendor bazohet në parimin e subsidiaritetit, konsultimit dhe bashkëpunimit¹. Këshilli Konsultativ është **forumi kryesor** ku qeverisja qendrore konsultohet me njësitë e vetëqeverisjes vendore për projektligjet, projektvendimet e Këshillit të Ministrave, projektpolitikat dhe projektstrategjitë që rregullojnë ose kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Miratimi i ndryshimeve në VKM nr. 244, datë 17.4.2024 “*Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore*” përbën vetëm hapin e parë në rrugën drejt forcimit të bashkëpunimit, rritjes së transparencës dhe efektivitetit të përfshirjes së njësive vendore në hartimin e të gjitha akteve që rregullojnë ose kanë ndikim të drejtpërdrejtë në të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Edhe sipas kuadrit ligjor që ka ekzistuar përpara miratimit të VKM-së nr.244, Këshilli Konsultativ funksiononte bazuar në parashikimet e rregullores së brendshme. Parashikimet e VKM-së 244 diktojnë miratimin e një rregullore të re që i përgjigjet atyre parashikimeve, si dhe sfidave të anëtarësimit në BE.

Nga pikëpamja strukturore dhe procedurale, ky projektakt synon të adresojë këto sfida:

- konsultimin dhe përfshirjen e njësive të vetëqeverisjes vendore (nëpërmjet shoqatave të tyre) që në fazat e para të hartimit të akteve ligjore;
- harmonizimin/konsolidimin e qëndrimeve midis njësive vendore me qëllim përcjellen e një qëndrimi të unifikuar/dakortësuar që i shërben interesave të përbashkëta dhe jo vetëm një apo disave prej tyre;
- përdorimin e kapaciteteve në mënyrën dhe formën e duhur, duke shfrytëzuar burimet njerëzore të specializuara që ekzistojnë në mënyrë efektive në të mirën e të gjithë njësive; dhe

¹ Neni 10 i Ligjit nr.139/2015, i ndryshuar “Për vetëqeverisjen vendore”

- krijimin e kushteve për hartimin e propozimeve *proaktive* dhe të konsoliduara nga ana e njësive vendore, që të mund të merren për diskutim dhe veprim nga ministrinë e linjës.

VKM nr.244/2024 parashikon se Këshilli Konsultativ duhet të miratoj **rregulloren e brendshme** të organizimit dhe funksionimit (pika 34). Më tej, nga pikëpamja e organizimit të brendshëm, në pikën 28 parashikohet se mund të krijohen **komisione këshillimi si struktura *ad hoc*** (në vijim Komision Ad Hoc), për të mbuluar fusha dhe sektorë specifikë që lidhen me funksionet e vetëqeverisjes vendore.

Parashikimet e kësaj projekt rregullore janë edhe në harmoni me nenin 6.4 të Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore që parashikon se “*autoritet lokale duhet të konsultohen, për aq sa është e mundur, në kohë dhe në mënyrën e duhur në planifikimin dhe vendimmarrjen për të gjitha çështjet që lidhen në mënyrë të drejtëpërdrejtë me to*”. Termat “mënyra e duhur” dhe “në kohë” synojnë të garantojnë përfshirje domethënëse, duke iu dhënë mundësi reale dhe efektive njësive vendore për të formuluar dhe artikuluar këndvështrimet/qëndrimet e tyre, duke influencuar vendimet përpara se ato të miratohen.

Referuar parimeve të Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës, e drejta e konsultimit të autoriteve vendore është thelbësore për promovimin e mirëqeverisjes, politikbërjes efektive dhe dhënies së shërbimeve në mënyrë efektive.

Referuar qasjes krahasimore në të gjitha vendet e BE-së, njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin pjesë rregullisht në dialogun politikbërës nëpërmjet shoqatave përkatëse, të cilat kanë rolin e tyre institucional në procesin e hartimit të politikave publike që prekin qeverisjen vendore, si përfaqësuese e interesave të përbashkëta të njësive vendore.



Parimet dhe Udhëzimet Evropiane mbi të drejtën e autoriteteve lokale për tu konsultuar

Gjithashtu, *Parimi i Partneritetit* është koncept bazë i Politikës së Kohezionit dhe programeve të tjera strukturore të investimeve të BE-së dhe për rrjedhojë është thelbësor për përmbushjen e detyrimeve për Kapitullin 22 (Politikat Rajonale dhe Koordinimi i Instrumentave Struktural). Në themel të saj qëndron ekzistenca dhe zbatimi i një kuadri ligjor që siguron gjithëpërfshirjen dhe bashkëpunimin e aktorëve në nivele të ndryshme të qeverisjes nëpërmjet cikleve të programeve. Progresi në dialogun midis qeverisjes vendore dhe qendrore është një aspekt për të cilën Komisioni Evropian monitoron vendin, për efekt të Raport Progresit Vjetor.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Baza ligjore mbi të cilën është hartuar ky projektvendim është neni 100 i Kushtetutës dhe pika 3, e nenit 12, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, si dhe pika 34 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.244, datë 17.4.2024 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk ka për qëllim përafrimin me *Acquis Communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Nga pikëpamja teknike, projekt-rregullorja përmban 32 nene.

Kreu I përmban dispozita të përgjithshme, duke përfshirë objektin e rregullores, parimet e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Konsultativ si dhe stemën dhe logon.

Kreu II përmban rregullime mbi strukturën organizative të Këshillit Konsultativ duke saktësuar në linjë me parashikimet e VKM-së nr.244, datë 17.4.2024 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, se ajo përbëhet nga:

- a) Bashkëkryetarët;
- b) Komisionet e Këshillimit Ad Hoc;
- c) Sekretariati Teknik.

Nenet në vijim parashikojnë përgjegjësitë e bashkëkryetarëve (neni 5) si dhe aspekte që lidhen me krijimin e komisioneve të këshillimit Ad Hoc (neni 6) . Duke qenë se VKM nr.244 parashikon në

mënyrë të detajuar detyrat e sekretariatit teknik, në nenin 7 të Rregullores bëhet një referencë tek këto parashikime.

Kreu III i dedikohet mënyrës se si funksionojnë komisionet e këshillimit Ad Hoc. Kështu, parashikohen shprehimisht kompetencat e këtyre komisioneve (neni 8), anëtarësia e tyre (neni 9), si dhe organizimi i punës (neni 10).

Kreu IV përmban rregullime mbi organizimin e punimeve të Këshillit Konsultativ dhe komisioneve të tij. Në nenin 11 parashikohet periodiciteti i takimeve. Neni 12 vendos detyrimin për të funksionuar bazuar në një program pune vjetor që hartohet bazuar në kuadrin ligjor dhe institucional në fuqi. Neni 12 përmban një rregullim të posaçëm në lidhje me procedurën për shqyrtimin e projektligjit të buxhetit të shtetit dhe projektligjeve financiare në frymën e parashikimeve të pikës 27 të VKM nr.244, datë 17.4.2024 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”.

Neni 14 parashikon mënyrën e bashkëpunimit të komisioneve me strukturat e partneritetit që lidhen me politikat e kohezionit dhe zhvillimit rajonal. Në të njëjtën linjë me parashikimet e nenit 12, edhe neni 15 parashikon që komisionet këshillimore Ad Hoc punojnë dhe organizohen bazuar në një program pune. Neni 16 i referohet mënyrës së organizimit të punës të komisioneve këshillimore Ad Hoc.

Neni 17 reflekton parimet e nenit 10 të ligjit nr.139/2015 “Për njësitë e vetëqeverisjes vendore” sipas të cilit marrëdhëniet midis qeverisjes qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore bazohen në parimet e subsidiaritetit, të konsultimit dhe të bashkëpunimit për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta. Në këtë kontekst, parashikimi për seanca dëgjimore me përfaqësues të qeverisjes qendrore për çështje specifike që ka ndikim të drejtëpërdrejtë në fusha dhe sektorë specifikë që lidhen me funksionet e vetëqeverisjes vendore merr rëndësi të veçantë.

Nisur nga rëndësia e parimit të partneritetit parashikuar në aquis, Rregullorja përfshin edhe një parashikim (neni 18) për seanca konsultuese me aktorë të tjerë si përfaqësues të institucioneve shtetërore ose publike, ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të grupeve të interesit, si dhe grupime të tjera të interesuara për ato çështje që lidhen me fusha dhe sektorë specifikë të funksioneve e vetëqeverisjes vendore të përcaktuara në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar dhe që paraqesin interes të veçantë për njësive të vetëqeverisjes vendore. Parashikimet në nenin 19 synojnë të standartizojnë mënyrën e shqyrtimit të çështjeve në komisione.

Në Kreun V parashikohen procedura për paraqitjen dhe vlerësimin e nismave nga përfaqësuesit e vetëqeverisjes vendore. Këtu merr rëndësi të veçantë mënyra se si vetëqeverisja vendore propozon nisma të ndryshme ligjore (neni 20). Nisma duhet të paraqitet në një dokument që përmban:

a) objektivat që synohen të arrihen me miratimin e tij;

- b) argumentet se përse objektivat nuk mund të arrihen me instrumentet ligjore ekzistuese;
- c) ndikimin e pritshëm ekonomik, financiar, social, mjedisor në nivel vendor.

Neni 21 parashikon procedurat e vlerësimit të nismës nga komisioni dhe Këshilli Konsultativ.

Kreu VI përmban rregullime për mbledhjet plenare dhe transparencën e veprimtarisë së Këshillit Konsultativ. Kështu neni 22 përfshin rregulla mbi rendin e ditës, ndërsa neni 23 për zhvillimin e mbledhjeve; neni 24 për rradhën e diskutimeve, ndërsa neni 25 për kohën e diskutimeve; dhe së fundmi neni 26 përcakton pjesëmarrjen dhe sjellën e anëtarëve.

Neni 27 përfshin rregullime për vendimet e Këshillit Konsultativ. Ndërsa neni 28 përcakton aspekte që lidhen me procesverbalin e mbledhjeve. Neni 29 disiplinon dokumentacionin që prodhon Këshilli, ndërsa neni 30 parashikon detyrimin për të hartuar një raport vjetor mbi veprimtarinë e Këshillit duke përfshirë analizën e punës të Këshillit dhe komisioneve, numrin e rekomandimeve që janë përgatitur nga komisionet dhe numrin e atyre të marrë në konsideratë nga qeverisja qendrore dhe një përmbledhje të atyre që janë refuzuar së bashku me arsyetimet përkatëse.

Kreu VII parashikon dispozitat kalimtare dhe të fundit, duke përfshirë ndryshimin e rregullores, dhe krijimin e komisioneve Ad Hoc për vitin 2025 duke parashikuar rregull përjashtimor.

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Këshilli Konsultativ (neni 32).

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohen anëtarët e Këshillit Konsultativ.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është hartuar nga grupi i punës i përbërë nga staf i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe ekspertë të Projektit EU4GoodGovernance, projekt i financuar nga BE. Në kuadër të hartimit të projektvendimit janë kryer disa takime konsultuese me përfaqësues të Ministrisë së Financave (anëtar të Këshillit) si dhe Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë.

Drafti përgatitur iu nënshtrua konsultimit paraprak me Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore si dhe dy shoqatat përfaqësuese të njësvive të vetëqeverisjes vendore.

Pas reflektimit të komenteve të tyre, drafti i konsoliduar do të dërgohet për mendim pranë Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor dhe pas përmbylljes së procesit të konsultimit, projektvendimi do të dërgohet për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Konsultativ.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky Vendim nuk ka asnjë efekt financiar.

PROPOZUES BASHKËKRYETARËT E KËSHILLIT KONSULTATIV

Arbjan MAZNIKU, MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR

Aldrin DALIPI, KRYETAR I SHOQATËS SË QARQEVE